



**BORDI
VENDIM
Nr. 2, datë 17.01.2019**

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIM TË “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI TË OFRIMIT TË DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE NGARKESËS NË PËRPTHJE ME NENIN 16 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE DHE MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE”

Në mbështetje të nenit 16, nenit 7, nenit 56 dhe nenit 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“, i ndryshuar, nenit 75 të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, nenit 26 të “Rregullave për Organizimin Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sha, është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 17.01.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimi i të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit European (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.

Konstatoi se:

- OST sh.a me shkresën nr. 8383 Prot., datë 11.12.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”.
- Dokumenti vjen në vijim të komunikimit Nr. 3886 prot. datë 25.05.2018 me objekt “Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 18 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë” dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë së Modelit të Përbashkët të Rrjetit.
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar me Ligjin nr 8/2018, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar

me vendim të ERE nr.186 dt. 10/11/2017, përkatësisht neni 117 “Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave”, si dhe nenet 118 deri 130 të tij.

- Dokumenti i përbërë nga 19 nene saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel Evropian analiza e sigurisë me qëllim alokimin e kapaciteteve dhe menazhimin e kongjestionëve.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 16 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionëve”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI